



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

**VENDIM**

Nr. 138, Datë 29-09-2022

**PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 22.08.2022  
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës **22.08.2022**, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

**VENDOSI**

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 22.08.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Erjon NEXHIPI**



## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 22.08.2022

Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z.Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 23

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 23 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z.Sotiraq Filo dhe drejtorë të ekzekutivit

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 1

### **Pika 1 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në lidhje me rendin e ditës ka diçka ju lutem? Nga këshilltarët ?

Sekretare e Këshillit: Pika 6 duhet të kalohet tek pika 5, dhe pika 5 të kalohet tek pika 6.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëhere hedhim në votim rendin e ditës me ndryshimin që pika 6 të kalohet tek pika 5 dhe pika 5 të kalohet tek pika 6.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 2 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALEVE TË MBLEDHJES SË DATËS 29 Korrik 2022.(me e-mail)

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka nga këshilltarët diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 3 e rendit të ditës**

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 Korrik 2022.

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.**

Këshilltare I.Nikaj: Propozoj miratimin e ndihmës ekonomike në relacionin e paraqitur nga Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtor i Kujdesit Social Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK. Për muajin Korrik , janë 46 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme” konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet romë dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022. Përfitojnë 46 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 117.986 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 25 familje, në shumën 31.552 lekë. Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 149.538 lekë. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, sipas kriterëve specifike të miratuara 20 familje, me fond prej 57.574 lekë specifikuar si persona të vetmuar, persona me pamundësi fizike për të punuar, kryefamiljarë gra me fëmijë të mitur në ngarkim, kryefamiljarë mbi moshë pune, familje të komunitetit rom dhe egjiptian me probleme dokumentacioni. I propozojmë Këshillit Bashkiak miratim të kësaj pike mbështetur në gjithçka është paraqitur në relacion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët e tjerë ka diçka për të shtuar?

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 4 e rendit të ditës**

PËR NJË NDRYSHIM NË V.K.B. Nr. 128 Datë 29.10.2020 PËR DISA SHITESA NË V.K.B. Nr. 28, datë 28.02.2019 “ PËR PËRCAKTIMIN E PRIORITETEVE TË INVESTIMEVE PËR VITET 2020 – 2022.

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica**

Nene, znj.Maria Dojçe dhe **(Komisioni i Zhvillimit Hapësinor dhe Infrastrukturës)** z.Raqi Themeli, z.Kristi Andrea, znj.Sara Koroveshi, z.Klaus Bacelli.

Këshilltare M.Nene: Referuar kuadrit ligjor të përmendur dhe në relacionin që i është drejtuar ekzekutivi si dhe burimeve përkatëse të këshillit bashkiak është propozuar një ndryshim në vendimin e këshillit të bashkisë nr.128 datë 29.10.2020 i cili do të financohet nga të ardhurat e Bashkisë dhe nga projekti SECO. Pas përfundimit të projekteve të detajuara detajuara inxhinierike për 9 rrugë në qytet dhe njësitë administrative, vlera e investimit për pikën A Infrastruktura Publike propozimi është që të ndryshohet rikonstruksioni i rrjetit të ndriçimit rrugor në kuadrin e efijencës së energjisë, me vlerë 83,000,000 lekë (në kjo përfshihen: Investimi, Lidhja e kontratave, mbikqyrje, kolaudim) në vlerën 95,472,985 lekë. Shpjeguar arsyeja pse kërkohet një ndryshim në këtë vlerë duke treguar investim, lidhjen e kontratave, mbikqyrjen dhe kolaudimin dhe kjo do të financohet edhe nga të ardhurat e bashkisë edhe nga projekti SECO që është përmendur në relacion. Ftoj anëtarët e Këshillit Bashkiak që të miratojnë ndryshimin në pikën A për zërin e Infrastrukturës Publike.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kryetari i bashkisë ka diçka për të shtuar?

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po janë dy materiale, ky dhe materiali tjetër më pas që lidhen me një projekt të bashkisë dhe unë doja të flisja për projektin. Është një projekt i cili ka në fokus përmirësimin e efijencës të energjisë në territorin e bashkisë të Korçës dhe konkretisht bëhet fjalë për efijencën e ndriçimit publik. Në kuadrin edhe të synimit të bashkisë që me projekte të caktuara ne të aplikojmë pranë programeve që financohen nga donatorë të ndryshëm. Në rastin konkret kemi aplikuar për këtë projekt para disa vitesh, të mbështetur nga qeveria Zviceriane dhe jemi 1 prej 4 bashkive që janë pjesë e këtij projekti në kuadër të të cilit ka disa masa që janë soft siç janë ngritja e strukturës të efijencës të energjisë në bashki apo hartimi dhe abdetimi të themi i planeve bashkiake të efijencës të energjisë, ndërkohë që ka dhe një komponent të investimit për të cilën po flasim tani në kuadrin e të cilit do të bëhet zëvendësimi i ndriçuesve ekzistues me ndriçues led. Një pjesë e konsiderueshme e rrugëve të qytetit të Korçës, dhe shumë e rëndësishme është dhe ajo pjesa e investimeve që i takon njësitve administrative pasi janë mbi 300,000,000 lekë të vjetra nga totali i këtij projekti që do të shkojnë për të mbyllur financimin dhe investimin në ndriçimin publik në të gjitha fshatrat e të gjitha njësitve administrative pjesë e bashkisë të Korçës. Ju e dini, ata këshilltarët që janë nga zonat rurale të bashkisë të Korçës që ne e kemi investuar deri tani në 2 faza të ndriçimit publik në fshatrat e bashkisë së Korçës, janë vendosur deri tani 1800 ndriçues pasi gjëndja që kemi gjetur në drejtim të ndriçimit publik ka qënë shumë e keqe dhe në këtë fazë besoj se do ti mbyllim komplet të gjitha nevojat e të gjitha fshatrave të bashkisë, brënda këtij fondi që unë përmenda 300,000,000 lekë të vjetra përveç ndriçuesve dhe të gjitha shtyllat e nevojshme apo linjat, kabllot e nevojshme për ta finalizuar këtë projekt. Ndërkohë për pjesën e qytetit ju gjithashtu e dini që ne prej kohësh, projekti i parë në fakt për kalimin e ndriçimit led ka që ai që kemi zbatuar tek bulevardi Republika në vitin 2012 mos gaboj kur kemi vendosur ndriçuset e parë led në qytet dhe që atëhere ne kemi vazhduar me modernizimin e ndriçimit duke kaluar në ndriçim led një pjesë të madhe, përveç bulevardit Republika është komplet hyrja e Korçës, rrugët Kiço Gleço, Midhi Kostani, shëtitore Fan Noli që është bërë me ndriçim led, Bulevardi Gjergj Kastrioti, komplet unaza e qytetit pjesa

më e madhe e saj në fakt është bërë me ndriçim led, por dhe atje ku nuk kemi kaluar me ndriçim led kemi bërë një kalim nga llambat e vjetra në llamba më efçente, ndërkohë që tani duam ta vazhdojmë këtë procesin e kalimit në ndriçim led. Janë projekte që janë edhe të kohës, ju-e dini që sidomos në situatën e viteve të fundit ka një problematikë të madhe jo vetëm në Shqipëri por në të gjithë Europën për furnizimin me energji elektrike dhe për çmimet e energjisë elektrike, kështu që çdo projekt që synon përmirësimin e efçencës pra uljen e konsumit të energjisë elektrike duke ruajtur standartin e ofrimit të shërbimit është i mirëpritur dhe jam shumë i kënaqur me këtë projekt. Ne po e vazhdojmë të hedhim hapa në drejtim të përmirësimit të efçencës së energjisë në ndriçimin publik në bashkinë e Korçës edhe në qytet edhe në fshatra, ndërkohë që projekte të tjera të efçencës do ja u prezantojmë në vijim, pasi efçenca e energjisë nuk lidhet vetëm me ndriçim publik, kemi efçencë të energjisë në godinat, prezantimi i sistemeve të termoizolimit në ruajtje të energjisë së brendshme dhe si rezultat edhe uljen e konsumit për ngrohje. Ne besoj shumë shpejt do të fillojmë dy projekte për të ndërhyrë. Ka qënë edhe kërkesa e banorëve dhe ja u kemi mbështetur si kërkesë në disa objekte me bashkëpronësi, pra pallate në qytetin e Korçës. Janë dy projekte në bashkëpunim me agjensinë e efçencës së energjisë pra Ministrisë së Infrastrukturës dhe e dyta me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, do të flasim më me detaje më vonë kur këto investime të fillojnë, por ajo që duhet thënë është që është një prej prioriteteve të punës të bashkisë dhe do të jetë edhe në të ardhmen, të gjitha ato projekte që synojnë përmirësimin e efçencës së energjisë në uljen me konsumin energjistik qoftë ai për ndriçim qoftë ai për ngrohje.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar, ndonjë pyetje ndonjë diskutim?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**PËR MIRATIM SHITESË FONDI PËR PROJEKTIN “SHFRYTËZIMI INTELIGJENT I ENERJISË (PROJEKTI I EFICENCËS SË ENERJISË)” , SI DHE MIRATIM FONDI PËR MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM PËR KËTË PROJEKT.**

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra kanë lidhje të dyja pikat me njëra tjetrën apo jo Bona?

Ekzekutivi V.Ziko: Vlera totale që do të investohet për këtë projekt shkon në vlerën 94,029,307 lekë. Financimi do të jetë si më poshtë:

- 66,720,000 lekë është kontribut i SECO e cila do të depozitohet në bankën e nivelit të dytë .

- 6,425,000 lekë është kontribut i bashkisë i cili është miratuar që me miratimin e buxhetit.
- 14,629,000 lekë është pagesa e TVSH-së nga MIE.
- 6,255,307 lekë shtesë fondi, kontribut i bashkisë.
- 1,318,854 lekë vlera e mbikqyrjes, kontribut i bashkisë.
- 124,824 lekë vlera e kolaudit, kontribut i bashkisë.

Në total vlera e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak është 7,698,985 lekë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 6 e rendit të ditës**

PËR MIRATIMIN E RITJES SË PLANIT TË BUXHETIT TË VITIT 2022 PËR BASHKINË KORÇË (GRAND NGA M.SH.M.S PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E STARTUP-EVE) NË VLERËN 19,999,008 LEKË, SI DHE MIRATIMIN E KONTRIBUTIT TË BASHKISË PËR PROJEKTIN “QENDËR INOVACIONI DHE KREATIVITETI MULTIFUNKSIONALE” NË VLERËN 9,729,011 LEKË.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mendoj që kryetari i bashkisë meriton të na informojë për këtë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Bëhet fjalë për një projekt i cili është pjesë e projektit më të madh të ndërtimit tek godina e ish këshillit të qarkut dhe Prefekturës, qëndrën për artin kulturën start up-et dhe inovacionin. Në kuadër të kësaj ambicieje ne kemi aplikuar tek thirrja që ka shpallur edhe Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, një thirrje për të financuar start-upe dhe operatorët që janë në fushën e teknologjisë dhe inovacionit për ti mbështetur ata për projekte dhe ide inovative. Projekti ynë ka konsistuar në një ndërhyrje tek salla e mbledhjeve që përdoret nga Këshilli i Qarkut dhe që në projektin tonë ka qënë një sallë dedikuar koncerteve, tani përveç këtyre aktiviteteve, përveç koncerteve do të përdoret edhe si një hapësirë multimediale. Pra në kuadrin e këtij projekti do të instalohet atje edhe një sistem për projeksjonin 3D në faqet anësore dhe në dyshemenë e sallës, janë sisteme moderne të projektimit të cilat krijojnë pastaj mundësinë që ne të organizojmë aktivitete të ndryshme, disa prej tyre janë listuar në këtë material, aktivitete që mund të jenë që nga ekspozita të arteve figurative të prezantuara në formën e projeksjoneve

dixhitale, mund të jenë aktivitete të promocionit dhe të aktiviteteve të koncerteve që do të vazhdojnë të kryhen atje. Kjo infrastrukturë që do të instalohet atje i krijon mundësinë edhe të një skenografie që do të realizohet me projeksion. Pra është një investim që i shton vlerë qëllimit fillestar tonit, pra për të pasur një sallë koncertesh të madhësisë së mesme që do të kishte mundësi të akomodonte aktivitete që deri tani janë bërë në teatër ndërkohë që kanë qënë për një audiencë më të vogël dhe përtej kësaj shton edhe mundësi për të organizuar aktivitete apo ngjarje apo prezantime të ndryshme me një teknologji shumë inovative siç është ai i projeksionit 3D hapsinor. Për ta realizuar këtë projekt ne siç thashë kemi aplikuar tek kjo thirrja e Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, kemi qënë një prej fituesve dhe me vlerën që kemi fituar do të realizojmë pjesën teknike të investimit, pra pajisjet edhe një pjesë të ndërhyrjes të anës ndërtimore që duhet për ta realizuar këtë vendosjen e këtyre pajisjeve, ndërkohë që është e nevojshme që të akomodohet edhe një fond nga bashkia për të plotësuar pjesën tjetër të ndërhyrjes ndërtimore. Dy fjalë për ecurinë e investimit në atë objekt pra kemi përbyllur fazën e parë të ndërhyrjes në këtë godinë, ndërkohë që tani kemi një fazë të dytë që do të përfshijë plotësisht këtë pjesën e interiorit sidomos në ambientin që është i dedikuar për galeri artesh dhe këto ambientet e tjera që janë të dedikuara për artin dhe kulturën dhe me këto dy faza të themi , këtë fazë që unë përmenda dhe fazën që fola më përpara për përshtatjen e kësaj salle përfundon edhe ndërhyrja në atë godinë, dhe shpresoj që sa më shpejt godinën ta kemi funksionale sidomos për pjesën e artit dhe të kulturës, ndërkohë që për pjesën e hapësirës dedikuar kompanive të teknologjisë që kemi bërë diskutim dhe në mbledhjen e mëparshme, lajmi pozitiv është që tashmë kemi lidhur kontratën e parë me një kompani nga Tirana në fushën e programimit e cila do të hapë degën e saj këtu në qytetin e Korçës duke punësuar një grup të rinjsh që ne i kemi trajnuar, gjithashtu më përpara në bashkëpunim me projektin e SBA-së dhe me mbështetjen e fondacionit Shqiptaro-Amerikan për zhvillim. Pra kjo kompani do të punësojë disa të rinj , do të ketë dhe 1 apo 2 punonjës në nivel më të avancuar që do jenë si team lider të themi, dhe shpresojmë që hapin e kësaj kompanie të kenë mundësi ta ndjekin edhe kompani të tjera. Besoj që jemi në rrugën e duhur që siç kemi folur të krijojmë një sinergji ndërmjet komponentëve të ndryshëm. Pra nga njëra anë të trajnojmë sa më shumë të rinj dhe të reja dhe nga ana tjetër t'ja ofrojmë këtë grup të rinjsh të trajnuar kompanive dhe ti ftojme që në bashkëpunim me ne të vendosen në qytetin tonë dhe të krijojnë mundësi punësimi. U zgjata pak pasi dhe vetë godina ka disa komponentë brënda saj, të gjitha janë të rëndësishme, arti kultura patjetër janë shumë të rëndësishme për një qytet si Korça, teknologjia është shumë e rëndësishme, hapja e perspektivave të punësimit për të rinjtë dhe të rejat do të jetë kryefjala e punës tonë shumë të rëndësishme në një qytet si Korça dhe shpresoj që të ecim në këtë drejtim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka, pyetje, diskutim?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 7 e rendit të ditës**

PËR MIRATIMIN E FONDIT SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJEN E OBJEKTEVE TË ARSIMIT PROFESIONAL.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Bona ndonjë gjë shkurt.

Ekzektuivi V.Ziko: Për të rritur më tej cilësinë e shërbimit në arsimin profesional, kërkohet nga Këshilli Bashkiak të miratohet fondi shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve të arsimit profesional, në vlerë 1,200,000 lekë. Ky fond do të përballohet nga fondi i planifikuar në buxhetin e vitit 2022, në zërin Investime në Infrastrukturën rrugore, nga programi Rrjeti rrugor rural me këtë strukturë buxhetore:

PAKËSOHET      00    04520    05    Art.2310000                      - 1,200,000 (Prog. Rrjeti rrugor rural, Bashkia)

SHTOHET            00    09230    05    Art.6020000                      + 1,200,000 (Arsimi Profesional, NSHMAC)

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka pyetje?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 8 e rendit të ditës**

KËRKESA-ANKESA TË QYTETARËVE.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Të dëgjojmë atëhere.

Qytetarja: Unë banoj në lagjen 5, kam një problem me shpinë. Kur e kam blerë, e kam blerë me kollona dhe nuk e dija se çfarë do bëheshe, atëhere jetoja jashtë në Greqi. Vija dhe shkoja disa herë, kur shikoj ngjitur me mua një sallon bukurie me xhama, sa ishte sallon bukurie nuk e kishte shitur e zonja e shtëpisë, nuk kishte njeri. E shiti dhe u bë banesë. Kur u bë banesë unë u shqetësova se dukeshe deri brënda, unë e bëj me dorë me komshiun, ka hapur derën, nuk laj dot



rroba, nuk ajrosemi dot, probleme të mëdhaja. Hajde shikojeni vetë, kush të dojë të vij ta shikojë si është në realitet. Kam bërë disa herë ankesa këtu tek juve dhe nuk më është zgjidhur problemi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në këshill ke bërë kërkesë, apo në bashki, në informacioni ?

Qytetarja: Ankesën e kam dërguar tek kryetari.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Më falni është rasti i pallatit të Lidës apo jo?

Qytetarja: E kam dërguar tek Këshilli Bashkiak, e kam dërguar tek ai çuni që merret me ndërtimin, inspektori disa herë. Kam shkuar dhe ata janë interesuar, kanë thënë nuk e kemi ne e ka bashkia. Edhe ju drejtova juve tani, kam 3 vjet që merrem, nuk kam asnjë rrugëzgjdhje.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mirë s'ka rëndësi, pavarësisht që s'ka patur kërkesë deri tani, cili është rasti kryetar se mos ndoshta dhe ju keni dijeni .

Kryetari i bashkisë S.Filo: Është rasti tek pallati përballë me zjarrfiksin ?

Qytetarja: Në zjarrfiksjë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po përballë.

Qytetarja: Jam shumë e shqetësuar, nuk di çfarë të them.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Tani unë e njoh pak rastin dhe e kam lënë porosi edhe tek inspektoriati jonë i ndërtimit që ta verifikojë. Në fakt është pak komplekse ajo situata atje, se është bërë një mbyllje ballkonit ndërkohë që ju thoni që më shohin, ballkoni edhe po të jetë i hapur prapë të shohin ata, se nuk është se ka qënë me mur.

Qytetarja: Kanë bërë dhe një derë atje se ka qënë pjesë e xhamllëkut. Një ditë kishte hedhur dhe cigare, do na verë zjarrin.

Kryetari i bashkisë S.Filo: E kuptoj.

Qytetarja: Nuk jam rehat në shtëpinë time. Po të isha në Greqi do ta kisha zgjidhur këtë problem, jam këtu në vëndin tim, në qytetin tim, në shtëpinë time dhe nuk zgjidhet problemi. Kam 3 vjet që vij rrotull. Ju lutem shumë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ja ta dëgjojmë kryetarin ju lutem.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Tani se ky problem nuk ka lindur para 3 viteve, që ti themi gjërat siç janë meqënëse keni erdhur në Këshill. Ai i tillë është bërë që në momentin që është ndërtuar pallati, këtu e sa vite të lutem më korrigjo pak. Mund të më japësh një përgjigje, kur është realizuar kjo gjëja siç është tani, se nuk ka 3 vjet, duhet të ketë që kur është bërë pallati. Po them ajo ndërhyrja që ka realizuar ai zotëria mund të jetë pa lejë dhe ajo që kërkon ti është jashtë projektit për të cilën është miratuar leja, këtë po them. Nuk është se unë mund ta detyroj atë që të realizojë gjënë që kërkon ti, se nuk është pjesë e lejës që është miratuar. Ti kërkon ta mbyllë me mur. Me mur nuk e ka as në lejë. Dakord ti themi ta mbajë hapur por nuk ta zgjidh këtë punën që thua që më shohin, se dhe nga ballkoni i hapur do të shohë, dhe nuk është një situatë e krijuar 3 vitet e fundit, por është krijuar që kur është ndërtuar pallati. Megjithatë do ta shoh përsëri, por ajo që do ti që të mbyllet me mur nuk është pjesë e lejës që ka marrë.

Qytetarja: E kam blerë vetë shtëpinë, nuk e kam blerë me komshinë që duhet të më shikojë komshia. Më vjen keq tani, dhe dy hyrje janë bërë poshtë në kat të parë janë bërë me xhamllëk, i kanë vënë derë i kanë vënë dritare, e kanë bërë me mur, vetëm kjo e imja nuk bëhet.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Edhe njëherë tani për ta mbyllur. Unë nuk e detyroj dot subjektin filan që të bëjë një ndërhyrje jashtë lejës së ndërtimit që ai ka marrë. Këtë nuk e detyroj dot.

Qytetarja: Është pa lejë zotëri këtë po them.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po mund të jetë pa lejë ajo që ka bërë dakord, por nuk i them dot që hiqe këtë dhe bëjë me mur, se dhe me mur nuk e ka me lejë.

Qytetarja: Me mur është i gjithë pallati deri në kat të 7.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Edhe njëherë tani të lutem, që ndërhyrja që kërkon ti nuk ka qënë pjesë e lejës së ndërtimit që ka zotëria dhe nuk e detyroj dot ti them bëjë tani se kështu e ke në lejë dhe e ke bërë jashtë lejës. Në lejë e ka ballkon të hapur dhe maksimumi që mund të bëjë unë është ti kërkoj ta ketë ballkon të hapur. Po kjo nuk ta zgjidh ty problemi që ai tjetri të të shohë.

Qytetarja: Ç'është kjo të më shikojë tjetri deri në dhomë të gjitha veprimet.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Dakord do ta shoh.

Këshilltari I.Nikaj: Është problematikë sjellja apo teknika.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Tani për ta kuptuar edhe njëherë, në lejën e ndërtimit që kam unë, ai zotëria apo firma e ndërtimit që ka aplikuar para 15 viteve e ka pasur ballkon të hapur. Që në momentin e ndërtimit siç e tha edhe zonja e ka mbyllur me ballkon dhe ka funksionuar parukeri të themi. Tani është shitur.

Këshilltare I.Nikaj: Vetëm ballkoni?

Kryetari i bashkisë S.Filo: Besoj komplet ambienti kati i parë ka funksionuar si biznes, dhe deri në atë moment zonja nuk ankoheshe. Tani është ndëruar nga parukeri është bërë banesë. Dhe tani zonja thotë që nga kjo ambienti me xham mua mund të më shohin.

Qytetarja: Jo mund të më shohin por më shohin.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Të shohin, dhe kërkesa është ta mbyllë me mur. Tani po them që nuk i detyroj dot ta mbyllin me mur se dhe murin nuk e kanë në lejën e ndërtimit, e kanë ballkon të hapur, dhe unë mund t'ju kërkoj jo ligjërisht mbylleni. Në momentin që ata nuk duan ta mbyllin për arsyet e tyre, nuk i detyroj dot të bëjnë një mur jashtë lejës së ndërtimit. Maksimumi që mund të bëjmë është ti heqim xhamin. Po kjo, po i them zonjës nuk ta zgjidh problemin e të parit. Se në mos xham do jetë ajër, transparent, do dalë do të shikojë.

Qytetarja: Siç e kanë bërë pa lejë deri tani le ta bëjnë prapë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Më fal o zonjë, tani të përdorim arsyetimin edhe llogjik. Ti mund të kesh shumë të drejtë për shqetësimin që ke, por nuk është e logjikshme të themi meqënëse ka bërë xhamin pa lejë le të bëjë edhe murin pa lejë se dua unë. Zere ti tënden po qe se kështu.

Qytetarja: Unë jam përballë me komshinë dhe shohin të gjitha veprimet që bëjmë brënda.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po do të shikojë prapë po të dojë të të shikojë edhe po të ikë xhami. Do të dalë në ballkon pa xham do të të shikojë.

Qytetarja: Ai nuk do rrijë tërë ditën në ballkon, do rrijë brënda. Ai e ka kuzhinë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po mirë pra dakord.

Qytetarja: Thashë po të isha në Greqi do e kisha zgjidhur , këtu jam në vendin tim.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Mund ta bëjë me tulla xhami.

Qytetarja: I morra paratë andej i solla këtu. Unë dua rehat, unë jam e smurë. Jam 72 vjet, ç'është kjo tani.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tani po të besdis ai komshiu?

Këshilltare I.Nikaj: Po tani ajo ka të drejtë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po pse ka të drejtë Irena? Ajo të drejtën e fjalës e ka , po ajo ndërhyrja tani nuk është bërë këto 3 vitet e fundit. Ajo ka qënë që kur është bërë pallati. Tani zonja e ka parë që kur është bërë pallati që ka qënë xhami. Në një moment nuk i prishte punë xhami, gratë kur prisnin flokët nuk e shqetësonin ato që mund të rrinin në karrige ta shikonin, tani ku ta di unë si e ka muhabetin me komshiun. Megjithatë ç'rëndësi ka të merremi. Me mur nuk do ta bëjë ai zotëria dhe unë nuk e detyroj të bëjë diçka jashtë lejës. Tani të merremi dhe njëherë të heqim xhamin dhe të shpresojmë të shpëtojmë nga kjo histori.

Qytetarja: Jo të heqim xhamin siç thë ai zotëria, hiq një xham ver një xham, ç'është kjo tani ? S'jam vetëm unë atje, unë kam 2 djem kam 2 nuse kam dhe disa fëmijë. Më vjen keq.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po për shembull një pyetje? Po të jetë xham jo transparent na i zgjidh problemin?

Qytetarja: Në asnjë mënyrë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Epo nuk e ke tek e para tani, ti e ke te komshiu. Me një xham jo transparent nuk do të shohin.

Qytetarja: U thye xhami.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Edhe muri mund të na bjerë, nuk është kjo llogjika. Mirë faleminderit zonjë që na i paraqite.

Këshilltarë E.Menkshi: Po mirë mund të shkohet edhe njëherë atje.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Edhe 10 herë i dërgoj unë ata vetëm që të gjendet një zgjidhje.

Këshilltarë E.Menkshi: Të vendoset ndonjë tendë ose diçka.

Qytetarja: Bëjani me tulla xhami zotëri, meqë dashki xham.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Dakord, më ler që të merrem.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Faleminderit zonjë. Atëhere Shoqata Tradita Mborjare me përfaqësues kryetarin zotin Muharrem Shehu fshati Mborje, i është drejtuar Këshillit Bashkiak dhe kryetarit të bashkisë dhe deputetit zoti.Niko Peleshi. Propozim për vendosjen e emrit Selim Mustafa Mborja në rrugën kryesore në qytetin e Korçës. Tani për jetën e Selim Mborjes ka shkruar me detaje, unë të paktën e di çfarë përfaqëson. Kjo është në kuadër dhe të kërkesave të tjera që ka për emërtesa rrugësh. Duhet të shikohen.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Domethënë në parim çfarë mund të them në këtë moment është patjetër figura e Selim Mborjes është një figurë e nderuar e qytetit të Korçës. Personalitet i rëndësishëm, biznesmen, investitor filantrop, pjesëmarrës edhe nxitës i shoqatave të ndryshme të qytetit të Korçës. Besoj profesor Pandi mund të flasë shumë gjatë edhe më gjërë se mua për këtë figurë. Është figurë e nderuar deri këtu nuk kam çfarë them. E vetmja pikëpyetje nuk i jap dot përgjigje tani, është si na shkon kjo kërkesë në raport me gjëndjen e emërimit të rrugve, sepse jemi në kushtet kur ai sistemi i adresave është bërë dhe nuk e di çfarë hapësira kemi për të bërë emërtime rrugësh. Këtë më duhet ta verifikoj. Si kryetar i bashkisë kam vlerësime maksimale për

këtë figurë. Të shohim këtë pjesën tjetër dhe pastaj të vijmë me një propozim konkret. Kaq mund të them në këtë moment.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Në parim e miratojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jo kjo është kërkesë.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Në rregull ne japim okay.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Okay, çështja është që vendimet janë konkrete. Po kështu dakord jemi, edhe emrat tanë le ti kemi në një rrugë.

Këshilltare E.Mitre: Puna është se nuk ka rrugë kryesore.

Këshilltare I.Nikaj: Pra me sa kuptoj kjo është çështja e të parit në një pamje vizive të emrit. Unë mendoj që ndoshta mund të gjendet një alternativë derisa rrugës ti vihet emri. Mundet një rrugë të jetë pasardhëse, mundet të mos e shikojnë ndofta shpesh, mundet të gjendet dhe një mënyrë e tillë. Pra mund të gjenden disa zgjidhje më të mira sesa emri i rrugës.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Këto propozime janë patjetër, mund të konsiderohen. Jam i papërgatitur për ta bërë shterues këtë diskutimin këtu. Të shohim çfarëdo lloj opsioni mund të përdorim për ta nderuar si figurë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Meqënëse është edhe 110 vjetori këtë vit i shpalljes së pavarsisë mund të shikojmë ndonjë gjë që të jetë dhe për figurat e tjera që janë të ngjashme. Po më fal profesor.

Këshilltar P.Bello: Selim Mborja nuk ka diskutim, meriton një vlerësim, por nuk është rasti konkret, nëse marrim në analizë situatën e këtyre komenteve e nevojës së orientimit të Korçës, janë dhe shumë figura të tjera, janë jashtëzakonisht shumë, dhe nuk është rasti të mburremi midis nesh, por Korça ka një traditë të shkëlqyer të kontributeve të fuqishme, dhe këto kontribute kanë edhe emra konkretë. Unë kam këtë mendim se në një mbledhje të shkuar në Këshillin e Kulturës dhe bashkë me këtë komision nga Këshilli Bashkiak, mund të shikohet në përgjithësi kjo se

përditë mund të vijnë kërkesa edhe nga të tjera dhe mund të jetë fjala dhe për rrugë dhe mund të mos jetë për rrugë. Ndërsa ne duhet të shikojmë nga pamja që problemi administrativ është i rëndësishëm, por edhe problemi i kujtesës është shumë i rëndësishëm. Dimë pak historinë e qytetit, nuk mund ta vesh kështu në mënyrë anonime, një emër që nuk thotë gjë. Ky është një shqetësim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jemi tek Selim Mborja profesor. Ky është anonim apo jo, që mos e kalojmë kështu.

Këshilltar P.Bello: Unë ju thashë që në fillim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Diskutimi teorik që të keni kujdes mos vendosni emra, po qe se ju referove batutës që kishte lidhje me emrat tanë.

Këshilltar P.Bello: Nuk ju referova juve.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Epo sepse ne nuk po diskutojmë emra të tjerë. Të jemi pak racionalë, sepse po diskutojmë jashtë kontekstit.

Këshilltar P.Bello: Jo nuk është jashtë kontekstit, ky është shqetësim që mua më preukupon prej shumë kohësh. Ka figura të mëdha të qytetit të Korçës që nuk i dinë njerëzit, nuk i njohin. Ne e kemi vënë emrin atje Kristo Kono, nuk e di njeri se kush është.

Këshilltare E.Mitre: Po e dimë, si nuk e dimë Kristo Konon.

Këshilltar P.Bello: Ai kapi majat e ajsbergut të muzikës klasike të paharruar Shqiptare. Ky është shqetësimi im, dhe pastaj them që nuk diskutoj për këtë moment, diskutoj në vazhdim. Të merremi një ditë me këtë gjë, të kemi kohë të diskutojmë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Shiko pak a shumë edhe profesori tha atë gjënë që thatë edhe ju, që mbase është momenti që të ngrihet një grup me përfaqësues nga këshilli nga universiteti, nuk e di kush janë institucionet e tjera që mund të japin një kontribut në këtë drejtim dhe të bëjë një

vlerësim të figurave të shquara të Korçës të fillimit të shekullit të 20. Të ngrihet një grup jam shumë dakord, ta bëjë këtë vlerësimin.

Këshilltar P.Bello: Mot ka 100 vjetorin e vdekjes Pandeli Cale, tani merri të rinjtë dhe pyeti kush është Pandeli Cale, nuk e di asnjë njeri kjo më preukupon shumë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pandeli Cale është një shkollë, kemi dhe rrugë, tani që duhet të promovojmë këto vlera më shumë është tjetër diskutim.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Mbase shiko profesor, se qëndron ai shqetësimi juaj, por u hap sfera e diskutimit. Në rastin e Pandeli Cales është problem patjetër, është problem fakti i kohës ku jetojmë se Pandeli Cale si figurë në kuptimin e emërtimeve të institucioneve apo rrugëve i është bërë, por të rinjtë përsëri nuk ja dinë kontributin dhe këtu është diskutim shumë i gjërë, roli i shkollës dhe në tekstet shkollore, roli i librave. Këto aktivitetet e ndryshme që mund të bëhen për të promovuar këto figura.

Këshilltar P.Bello: Një shqetësim që kam është se varri i Pandeli Cales është në ditë të hallit, emri ku është vënë artist i meritura nuk është. Megjithatë mua mu kujtua meqë ka 100 vjetorin, kemi kohë të diskutojmë për këtë gjë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Çfarë ju duhet nga ana jonë si bashki për tu mbledhur?

Këshilltar P.Bello: Jo unë thjesht e paraqita si shqetësim.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Qëndron shqetësimi, tani të bëjmë diçka konkrete. Unë jam i gatshëm, konkretisht më thoni.

Këshilltare I.Nikaj: Pra duke i marrë me vlerësim të gjitha ato diskutime, pra përveç pjesës së ndërtimit të një grupi që do të na japë çfarë mungon në Korçë, unë mendoj dhe në rastin e zotit Mborja pra do të duhet të gjejmë mënyra alternative për ti bërë të pranishëm brënda kësaj hapësire sociale të gjitha ato që mungojnë qoftë si kontribute apo dhe emra fizikisht, dhe nuk është vetëm çështje e emërtimeve të rrugëve, ka dhe alternativa të tjera, e kam propozuar dhe herë tjetër që disa veprimtari që bëhen mund të jenë me përcaktim.



Kryetari i bashkisë S.Filo: Të quhet kampionati filan.

Këshilltare I.Nikaj: E kam fjalën të bëhet diçka përveç grupit që do të evidentojë çfarë na mungon nga kujtesa, dhe mënyrën se si ti ndërtojmë këto dhe në mjedise të veçanta veprimtaritë që bëhen për krijimin e këtyre veprave artistike. Mund të synojmë fjala vjen që të gjejnë forma më të përshtatshme për ta bërë të madhin Kristo Kono midis njerëzve. Një stol që të ulesh me Kristo Konon ose një skulpturë. Të jenë gjëra të natyrës artistike, krijuese dhe të mënyrave të tjera, shpeshherë dhe të lidhura specifikisht me atë që kanë bërë këta njerëz të shquar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: I frymëzuar nga fjala e zyshës, unë propozoj që sheshi në trekëndëshi që është shumë i mirë, dhe që ka lidhje me Selim Mborjen të marrë emrin Selim Mborja, dhe është shesh, bashkë me atë pjesën e lulishtes.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Jam shumë dakord, vetëm kam merakun në raport me sistemin e adresave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jo nuk ka ndikim ajo. Nuk ka adresë sheshi.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Jo ka adresë sheshi, sheshet janë pjesë e sistemeve të adresave. Lulishtet jo. Megjithatë është një ide, do ta shikojmë. Edhe diçka tjetër shumë e rëndësishme që tha profesor Pandi dhe duhet ta bëjmë, është minimalisht ai rikonstruksioni, rindërtimi i varreve të personaliteteve. Më ka ndodhur dhe në disa raste të tjera kam dëgjuar që nuk e ka varrin në gjëndje të mirë dhe është minimumi i respektit që mund të tregojmë. Kështu që si mund të na ndihmoni që ti evidentojmë.

Këshilltar P.Bello: 100 vjet më përpara janë bërë me dinjitet të lartë. Në Themistokliu nuk shkruheshe Themistokli Gërmenji, por Themistokli Gërmenjit Korça, dhe atje janë eshtrat e Themistokliut. Nuk jemi të preokupuar kështu, ky është qyteti jonë si duam ta zbukurojmë, duke bërë luftë me njëri tjetrin.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po këtë të varrezave si mundet.

Këshilltare E.Mitre: Po atje ka një libër, ka një regjistër ku mund ti gjesh sipas parcelave domethënë janë me emra.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Këtë mos e lemë në kontekstin e fjalëve , ne kemi diskutuar dhe vjet këtu në këtë sallë që duhet të evidentohen të paktën të fillojmë me ata që ju është dhënë titull "Qytetar Nderi" apo "Emblema e Artë e Qytetit", të evidentohen me emër dhe me biografinë për të thënë pse, edhe emërtesat e rrugve apo emërtesat e shkollave se ne na ndodhi kjo që lexojmë një emër dhe nuk e dimë çfarë përfaqëson. Ndodh për shumicën e njerëzve por edhe për njerëz që kanë informacion më të zgjeruar, dhe më pas pastaj mbase duke u botuar në një libër mund të shërbejë dhe për të promovuar këto figura, këta njerëz që kanë dhënë kontribute në këtë vënd dhe me punën e përditshme të themi të evidentohen figura të tjera që kanë dhënë kontribut që siç e thotë dhe profesor Pandi janë të shumtë. Është një gjë që duhet të jetë punë e përditshme , nuk e di deri ku jemi me evidentimin?

Sekretare e Këshillit E.Naci: Ne kemi evidentuar nga viti 2009.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Bashkia Korçë ka ekzistuar që në vitin 23.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po për Qytetar Nderi se di tani.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Të bëhet një punë e jashtme të themi një doktoraturë nga dikush që të ketë interes, se ne nuk arrijmë dot që ti evidentojmë.

Këshilltare E.Menkshi: Kjo ideja e doktoraturave është ide shumë e mirë. Shumë pak e njohin qytetin tonë dhe historikun e qytetit tonë, unë e kam cekur dhe tek studentët e histori gjeografisë që të marrin tema diplome për historinë e qytetit për figurat e shquara. I kam motivuar studentët që të shkojnë të studiojnë tek biblioteka, gjithsesi janë disa aktivitete disa institucione të specifikuar që lidhin të rinjtë me qytetin me historinë.

Këshilltare I.Nikaj: Ne folëm për emrat e rrugëve që janë anonim. Unë mendoj që ato mund të plotësohen me gjëra të tjera. Të japim një arsye se pse ja kemi vendosur këtë emër.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kjo ishte llogjika e asaj që thashë unë. Sot me mundësitë që ka dhe teknologjike të jetë e aksesueshme dhe në faqen e bashkisë që kemi këto personalitete dhe e gjejnë se çfarë është ky? Se nuk do bëhen hartime në rrugët.

Këshilltare I.Nikaj: Jashtë Shqipërisë kështu është .

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në Itali e kam parë unë që është arkitekti për shembull ose heroi ose filantropi .

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëhere kërkesë drejtuar kryetarit të bashkisë z. Sotiraq Filo, drejtuar këshillit bashkiak z. Erjon Nexhipi , Këshillit Bashkiak unë i nënshkruari Suli Selajdin Agolli lindur më 04.03.1961 në Damjanec, Korçë dhe aktualisht me banim në Tiranë, në adresë: Rruga "Millosh Shutku", Pallati Dajti 9, Shk.1, Hyrja 38, parashtroj kërkesën time si më poshtë vijon:

Në vitin 1994, disponoja një banesë në fshatin Damjanec, të cilën ia kam shitur komunës Voskop, me destinacion për Infermieri. Theksoj se edhe bashkëshortja ime ka qënë infermiere dhe qëllimi tonë ishte që kjo ndërtesë të ruheshe. Me kalimin e viteve u ndërtua një Qëndër e re Infermierie dhe kjo ndërtesë u braktis dhe u uzurpua nga një banor tjetër i fshatit Damjanec, i quajtur Sefer Gurtali Notolli. Kërkoj që këtë pronë ta marr sërish unë, pronari i vërtetë i saj duke paguar vlerën që parashikon ligji për ta rikonstruktuar.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Këtë nuk e di më duhet ta verifikoj. Kërkesa e zotërisë, ky ia ka shitur komunës dhe tani kërkon ta riblejë përsëri në rast se bashkia do dojë ta shesë atë si pronë. Tani në parim këto privatizimet e objekteve në kuptimin e shitjes nuk i bën bashkia, i bën një drejtori nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ajo që duhet të bëjmë është të verifikojmë nëse e kemi këtë objekt në inventar apo jo. Qëndër shëndetsore në Damjanec nuk do ketë fare sepse Damjaneci është shumë pak familje.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakord po qe se kjo ndërtesë është në pronën tonë, pse duhet ta marrë dikush tjetër.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Jo nuk po them që ta marrë dikush tjetër duhet ta verifikojmë njëherë dhe në rast se nuk na duhet le të privatizohet, por ta kuptojmë njëherë çfarë është, për çfarë shërben, për çfarë përdoret. T'ja kalojmë Drejtorisë Juridike që ta ndjekë, të shohë se çfarë ndodh me këtë pronë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tjetër është Shoqata e Pingpongut Korçë me rastin e 1 vjetorit të largimit nga jeta e pingpongisti Korçar doktor Thoma Stratobërda do të organizojmë në qytetin tonë një aktivitet ballkanik të veteranëve të Pingpongut mosha 45-75 vjet në datat 16-17 shtator

2022. Jep një shpjegim të shkurtër të të gjithë jetëshkrimit të doktor Thoma Stratobërdës dhe e ka shoqëruar dhe me një preventiv. Nuk e di kryetari i bashkisë ta shikojë këtë.

Këshilltare A.Verushi: Së pari unë shoh që ka një emër ku thotë Shoqata e Pingpongut pa emër të kryetarit të shoqatës dhe pa një vulë të shoqatës. Së pari shoqata në qoftë se është shoqatë është e rregjistruar, pra ka një vulë të sajën, sepse unë nuk e di se si bashkia, unë jam shumë dakord që bashkia me punën e saj ka mbështetur shoqata të ndryshme për aktivitetet e tyre por nuk e di sesi do ta mbështetë dhe ku do ti çojnë këto para?

Kryetari i bashkisë S.Filo: Ajo ka vënë një preventiv nga mbrapa . Unë nuk e di nëse këta janë të formalizuar , besoj duhet të jenë të formalizuar , por nuk jam i sigurt.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kjo është pjesë e formës, tani jemi tek përmbajtja, forma patjetër që është e rëndësishme do ta shikojmë dhe formën.

Ekzekutivi V.Ziko: Aktiviteti mund të bëhet vetëm nëse e bën bashkia.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Tani në parim se dhe unë tani e pashë këtë kërkesën. Çfarëdo lloj aktiviteti që i vlen sportit, qoftë edhe sportit veteran vlen për mua. Ne kemi organizuar para 1 viti një kampionat shumë të bukur të atletikës në nivel ballkanik edhe përtej ballkanit se kishte edhe nga Ukraina sportistë edhe nga vënde të tjera , edhe nga Europa. Ishte aktivitet shumë i mirë, solli shumë njerëz edhe familjarët e tyre , krijuan goxha atmosferë dhe në këtë kuptim ja vlen të mbështetet. Niveli i mbështetjes është pak i madh, për shembull mbështetja për këtë kampionatin ballkanik të atletikës ka qënë 500,000 lekë vjet mos gaboj. Domethënë mund ti mbështetim por jo në këtë nivel , në momentin që jemi, por ta shohim edhe një herë si jemi me këto shpenzimet dhe pastaj mund të shohim edhe ndonjë donator, se shikoj disa zëra këtu.

Këshilltare I.Nikaj: Pjesën formale unë nuk e di si do zgjidhet, por mua më intereson që siç e kam përmendur edhe për sportet e tjera edhe për pingpongun i cili më duket një sport që ka nevojë për mbështetje. Unë luaj pingpong por çështja është që nuk ka një mjedis për pingpongun dhe ajo tavolina e pingpongut është në vendin jo të duhur dhe gjithmonë sa herë ka veprimtari të tjera duhet të pushojnë ata që duan të luajnë pingpong. Ndoshta duhet menduar për diçka ashtu si mendoj edhe për tenis apo për shahun të cilët janë sporte që nuk e kanë ndoshta nevojën për aq investime sa kanë disa sporte të tjera por efektin tek fëmijët të rinjtë dhe të gjitha moshat e kanë shumë herë më të mirë, qoftë nga pikëpamja e mirëqëniës fizike edhe e mirëqëniës mendore. Pse e them këtë, sepse dhe shahu dhe tenisi apo dhe pingpongu mund të mos kenë nevojë për investime kaq domethënëse, por kërkojnë përgatitje fizike dhe njëkohësisht ju japin shumë

shance të gjithë atyre që e ushtrojnë këtë që të jenë më të suksesshëm në punën e tyre. Prandaj unë e shikoj me respekt këtë kontribut, ju e shikoni është doktor zoti Thoma që ka ushtruar pingpongun ashtu siç ka dhe shumë që si amatorë i kanë ushtruar sportet dhe ju ka dhënë shumë dorë në problemet që kanë pasur. Problemet profesionale të një mjeku janë të mëdha, stresi më i madh është pikërisht në profesione të tilla siç janë të mjekësisë. Prandaj mendoj që duhet ti kushtojmë rëndësi këtyre gjërave që mund t'ju duken të vogla por në fakt kanë rëndësi sepse ju japin shancin shumë njerëzve që të ushtrojnë një sport në një periudhë që Korça ndoshta mund ta ketë të ftohtë dhe mund të mos jenë të mundshme jashtë në natyrë, prandaj veprimtari të tilla i shikoj shumë të rëndësishme. Çështja se sa do ti mbështetni ju pastaj është çështje tjetër.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Unë në parim thashë që jemi dakord për mbështetjen çfarëdo lloj aktiviteti, edhe sportit profesionist edhe sportit veteran. Ajo që na duhet të shohim është masa me të cilën mund të mbështeten. Nuk e di ku e kanë menduar ta zhvillojnë.

Këshilltari I.Nikaj: Tek NPV-ja.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ndoshta për tu bërë kampionati nuk është i përshtatshëm atje. Atje kanë kështu që luajnë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Në parim jam dakord.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Me atë ç'kuptova unë kërkon bashkëpunim më ato mundësitë dhe ndonjë mundësi tjetër që ndërtesa të restaurohet.

Këshilltari A.Verushi: Në dijeninë time ata nuk kanë asnjë mundësi, ajo është ndërtesë në pronësi të Këshillit të Qarkut. Unë personalisht i kam shkuar dhe i kam thënë nxirr një buxhet sa shkon dhe ta mbështetim dhe ne si Këshill.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Ai objekt është në pronësi të Këshillit të Qarkut, i cili ka dhe një lloj buxheti sa ta përballojë një lyerje, po qe se bëhet fjalë për këtë.

Këshilltari A.Verushi: Fasada e jashtme.



Kryetari i bashkisë S.Filo: Nuk besoj që është ndonjë vlerë që se përballojnë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pavarësisht se kush e ka sjellë këtë kërkesën për mua duke marrë në konsideratë që ta lini si objekt atje, poliklinika u rikostruktua shumë mirë, ajo ndërtesa multifunkionale po bëhet shumë mirë , kjo ndërtesë ka nevojë për një rinovim qoftë dhe të lehtë mbase me ndonjë ndriçim shtesë apo gjë tjetër dhe me lulishten këtej poshtë dhe me rikostruksionin e shkollës Themistokli Gërmenji që po bëhet, të bëhet një ansambël, pavarësisht kush e ka ndërtesën.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Meqënëse je dhe këshilltari dhe kryetari i Këshillit bëj një kontakt. Kanë bërë ndonjë preventiv ? Në rast se nuk kanë bërë preventiv çu ndonjë nga këta inxhinierët tanë. Të lutem Sara hidhini një sy objektit, çfarë duan të bëjnë. Ndonjë kontribut të vogël.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Për mua po ta shikojmë në këtë kontekst nuk ka rëndësi kush e ka inisiativën apo kush hedh idenë.

Këshilltare A.Verushi: I është kërkuar bashkisë që siç është bërë ndërhyrja në fasadat e institucioneve apo dhe objekteve të tjera private, të shikohet dhe ajo si godinë. Unë i thashë hajde ta bëjmë bashkarisht.

Kryetari i bashkisë S.Filo: E para e punës është ajo që the ti me të drejtë që nuk mundet që qiramarrësi të marrë vendime për objektin, vendimet duhet ti merrni ju. Jam shumë dakord të bëhet, të shikohet sa shkon, në rast se duhet të mbështetet e mbështesim dhe të mbyllet si histori.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



**KRYETARI**

**ERJON NEXHIPI**

